



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 27 dhjetor 2011
Nr. ref.: RK182/11

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në

Rastin nr. KO 117/10

Parashtrues

Kryetari i Komunës së Hanit të Elezit, Rufki Suma,

**lidhur me emrin e Komunës së Hanit të Elezit, në gjuhën serbe e njohur si
Gjeneral Janković**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

E përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Ivan Čukalović, gjyqtar
Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtare dhe
Iliriana Islami, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruesi i kërkesës është Kryetari i Komunës së Hanit të Elezit, Rufki Suma, i përfaqësuar nga Bajrush Laçi, përfaqësues juridik i Komunës.

Objekti i çështjes

2. Parashtruesi i kërkesës pretendon se është shkelur neni 3 [Barazia para ligjit] i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta). Parashtruesi i kërkesës po ashtu pretendon se është shkelur dëshira e lirë e qytetarëve të Komunës së Hanit të Elezit.

Baza juridike

3. Kërkesa është e bazuar në nenin 113.4 të Kushtetutës, nenin 41 të Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji), dhe rregullin 56 (2) të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Ligji i kontestuar

4. Në këtë kërkesë parashtruesi i kërkesës konteston emrin e Komunës së Hanit të Elezit në gjuhën serbe si Gjeneral Jankoviq, i cili është paraparë me Ligjin për Kufijtë Administrativ të Komunave, në versionin serbisht të atij Ligji (2008/03-Lo41). Ligji i cekur ishte miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës më 20 shkurt 2008 dhe hyri në fuqi më 16 qershor 2008.

Procedura në Gjykatë

5. Më 26 nëntor 2010, parashtruesi i kërkesës e paraqiti kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 29 nëntor 2010, Kryetari e emëroi gjyqtarin Altay Suroy si Gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues në përbërje të gjyqtarëve Snezhana Botusharova (kryesuese), Enver Hasani dhe Iliriana Islami.
7. Më 18 maj 2011, pas shqyrtimit të raportit paraprak të Gjyqtarit raportues, Kolegji shqyrtues i rekomandoi Gjykatës së plotë papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

8. Parashtruesi i kërkesës deklaroi se kishte ankesa të numërta nga qytetarët, shoqatat e ndryshme dhe bizneset kundër emrit të Komunës në gjuhën serbe të njohur si Gjeneral Jankoviq.
9. Kështu që, parashtruesi i kërkesës, duke pasur parasysh Rregulloren e UNMIK-ut 2000/43 për Numrat, Emrat dhe Kufijtë e Komunave, në emër të qytetarëve ua ka drejtuar një mori letrash institucioneve qendrore. Parashtruesi i kërkesës pohon se asnjë nga institucionet e adresuara nuk iu përgjigj kërkesave të tij për ndërrimin e emrit.
10. Parashtruesi i kërkesës përfundimisht deklaroi se qytetarët kanë paralajmëruar se nëse vazhdohej t'u dërgohen faturat e taksave në pronë me emrin Gjeneral Jankoviq, ata do të bojkotojnë dhe do të ndërpresin pagesat e taksave.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

11. Siç është cekur më parë, parashtruesi i kërkesës pretendon shkeljen e nenit 3 [Barazia para ligjit] të Kushtetutës, sepse emri i Komunës në gjuhën serbe është Gjeneral Janković, e që sipas parashtruesit të kërkesës, është emër i dhunshëm i imponuar nga regjimi komunist.
12. Parashtruesi i kërkesës ankohet se përkundër kërkesave të numërta për amendamentimin e Rregullores së UNMNIK-ut 2000/45 përkitazi me emrin e Komunës në gjuhën serbe, Ligji për Kufijtë Administrativ të Komunave mbajti këtë emër.
13. Kështu që, parashtruesi i kërkesës kërkon që Gjykata Kushtetuese të gjejë shkeljet e Kushtetutës përkitazi me emrin e Komunës në gjuhën serbe.

Vlerësimi i pranueshmërisë

14. Për të qenë në gjendje të gjykojë mbi kërkesën e parashtruesit të kërkesës, Gjykata Kushtetuese duhet paraprakisht të vlerësojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar të gjitha kushtet e pranueshmërisë të cilat përcaktohen me Kushtetutë, specifikuar me Ligjin për Gjykatën Kushtetuese dhe Rregulloren e punës.
15. Lidhur me këtë Gjykata rikujton se neni 113.4 i Kushtetutës thotë si vijon:

“Komuna është e autorizuar të kontestojë kushtetutshmërinë e ligjeve ose të akteve të Qeverisë, të cilat cenojnë përgjegjësitë komunale ose zvogëlojnë të hyrat e komunës, në rast se komuna përkatëse është prekur nga ai ligj ose akt.”
16. Gjykata më tutje vëren se neni 41 i Ligjit parashih afatet për procedurat e rastit të definuara me nenin 113. 4 të Kushtetutës si vijon:

Neni 41

Afatet

“Kërkesa duhet të dorëzohet brenda një (1) viti pas hyrjes në fuqi të dispozitës ligjore apo aktit të qeverisë që kontestohet nga ana e komunës”.

17. Në Republikën e Kosovës, Ligji për Kufijtë Administrativ të Komunave “rregullon organizimin territorial të vetëqeverisjes lokale, themelon komunat e reja, përcakton territorin e komunës si njësi e vetëqeverisjes lokale, definon kufijtë administrativ komunal, emrat dhe selitë e komunave të reja, vendosen rregullimet kalimtare në mes të komunave ekzistuese dhe komunave të reja të themeluara me këtë ligj, si dhe definohen procedurat për ndryshimin e kufijve administrativ të komunave” (shih nenin 1 të Ligjit 2008/03-Lo41).
18. Neni 5.5 i Ligjit për Kufijtë Administrativ të Komunave në pjesën përkatëse thotë si vijon:

“Komunat në vijim do të themelohen me zonat kadastrale të renditura në këtë ligj dhe selitë të përcaktuara më poshtë:

33. Komuna e Hani i Elezit me seli Hani i Elezit;”

19. Në gjuhën serbe fjalia e cituar më lartë është: “Komuna e Gjeneral Jankoviqit me seli në Gjeneral Jankoviq.”
20. Gjykata vëren se kërkesa ishte dorëzuar më 26 nëntor 2010, çka është më shumë se dy vite nga hyrja në fuqi e dispozitave të kontestuara të Ligjit për Kufijtë Administrativ të Komunave, i cili ka hyrë në fuqi më 16 qershor 2008.
21. Rezulton se kërkesa nuk i ishte paraqitur Gjykatës brenda afatit të paraparë me nenin 41 të Ligjit.
22. Nga kjo rrjedh se kërkesa e parashtruesit të kërkesës duhej refuzuar si e papranueshme ngase ishte e parashkruar.

PËR KËTO ARSYE


Gjykata Kushtetuese, në përputhje me nenin 113.4 të Kushtetutës dhe nenin 41 të Ligjit, me shumicë votash:

VENDOSI


- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;
- II. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese



Altay Suroy



Prof. Dr. Enver Hasani